



*Vlera të larta teorike - profesionale në një
shërbim që ofrohet me çiltërsi dhe fines.*

Raporti i transparencës 2024

FIN-EST

Përmbajtja

Kush jemi ne.....	2
Struktura funksionale dhe sistematizimi i stafit	4
Sistemi i kontrollit të cilësisë	4
Lista e njësive ekonomike me interes publik	5
Informacioni financiar	5
Deklarata e praktikave të pavarësisë të shoqërisë audituese	5

Kush jemi ne

“FIN-EST” është një shoqëri shqiptare me qendër në Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 28/10/2007 me NIPT K7222800612. Shoqëria është themeluar nga Enkeleda Stefani, Auditore Ligjore, si shoqëri person fizik. Është e përkushtuar për profesionalizëm dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve të auditimit dhe konsulencës.

Qasja jonë është të përshtatim cilësinë e shërbimeve me kërkesat e klientëve tanë, sado të mëdhenj apo të vegjël që të jenë, për të punuar në partneritet dhe për të kërkuar së bashku zgjidhjet e duhura.

Themeluar në Tiranë në tetor 2007, si shoqëri kontabiliteti dhe më pas në 2010 si shoqëri auditimi. “FINES” është një kompani private e pavarur dhe dinamike që ka kryer shërbime të kontabilitetit, auditimit dhe shërbime të tjera siç përshkruhet më poshtë.

Kompania jonë ka një Partner për shërbimet e auditimit i cili është edhe administratori i kompanisë.

- Enkeleda Stefani - Përfaqësuese e Përgjithshme & Auditore Ligjore

Celular: + 355 68 20 05 013

E-mail: enkeleda.s@fin-es.com

enkeleda_m@yahoo.com

Partneri është i regjistruar në Institutine Ekspertëve kontabël të Autorizuar të Shqipërisë si Auditues Ligjor i Licencuar.

Ne kemi Partnerin Ligjor dhe kemi mbështetjen në punën tonë të auditimit me:

- Shoqëria ligjore “K&H Services”.

Ne bashkëpunojmë me ekspertë në vlerësimin e pronësisë private dhe publike, ekspertë të paketës së kontabilitetit SAP, Navision, ALPHA Business dhe paketës së kontabilitetit Finance 5.

SHËRBIMET NE OFROJMË

Ne ofrojmë një portofol shërbimesh auditimi , dhënie sigurie , kontabiliteti dhe konsulence për një bazë të larmishme klientësh. Shërbimet tona kryhen në përputhje me Standardet kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Shërnimet tona përfshijnë :

- Përgatitje të pasqyrave financiare mujore dhe vjetore në përputhje me SNRF-të dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Drejtojmë ose mbështesim punën e auditimit të menaxhimit,
- Këshilla ligjore dhe tatimore,

- Konsulencë në projektet e punës së auditimit të brendshëm,
- Vlerësime, analiza, plane biznesi, monitorime dhe vlerësime të specializuara.
- Dizajnimi dhe ofrimi i trajnimeve në auditimin e brendshëm, shërbimet e kontabilitetit dhe auditimet e menaxhimit,
- Përkthime, interpretime dhe redakte të botimeve të specializuara.

STAFI YNË

Kompania “FINES” mbështetet nga një staf vendor mjaft kompetent dhe i përkushtuar në punë.

Stafi i shoqërisë dhe bashkëpunëtorët përbëheshin si më poshtë:

Enkeleda Stefani – Auditues Ligjore, Licencuar nga IEKA-Instituti i Kontabilistëve Publikë të Certifikuar si Auditues Ligjor në vitin 2010 me Licence Nr 208

Ka marrë “Diplomën e avancuar të ACCA në Kontabilitet dhe Biznes” nga Association of Chartered Certified Accountants, në vitin 2021

Gerti Dajko – Kandidat për Audit Ligjor, i certifikuar si Kontabilist i Miratuar nga IEKA-Instituti i Kontabilistëve Publikë të Miratuar në vitin 2022.

Blerina Lleshaj – Kandidate për Auditore Ligjore, e certifikuar Kontabiliste e Miratuar nga IEKA-Instituti i Kontabilistëve Publikë të Miratuar në vitin 2024.

Aishe Dedja – Kontabiliste /analiste financiare, e vlerësuar me titullin “Master Profesional në Kontabilitet” nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës në vitin 2017. Rregjistruar si Studente e ACCA

Evelina Sota – Kontabiliste / Analiste financiare, e vlerësuar me titullin “Master shkencash në ekonomi dhe agrobiznes, profili i menaxhimit të agrobiznesit” nga Universiteti Bujqësor i Tiranës në vitin 2017.

Ka marrë Certifikatë në “ Prokurime Publike (fusha e manaxhimit) nga ISSAT Trajnime

Eva Basha – Kontabiliste/ Analiste financiare, asistent audituese dhe kontabiliste, e vlerësuar me titullin “Master shkencash në Kontabilitet dhe auditim” nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës në vitin 2019.

Ka marrë Certifikatë në “ Menaxhim projektesh” (fusha e manaxhimit) nga ISSAT Trajnime

Rregjistruar si Studente e ACCA

Edvin Stefani Ph.D. – Këshilltar tatimor dhe analist financiar me një eksperiencë të gjerë si konsulent privat për tatimet, financat dhe kontabilitetin i njohur nga BERZH, USAID etj. Mbi 10 vite pedagog në fushën e taksave në universitete shtetërore dhe private. Ka marrë titullin Doktor i Shkencave në vitin 2006 në tatimin me temën “Diferencimi i TVSH-së” duke përdorur probabilitete stokastike. Autor i librave "Taksimi Normativ" (2018) dhe "Taksimi Pozitiv" (2020).

KLIENTËT TANË

Klientët tanë variojnë nga Individët tek organizatat shtetërore dhe private, Organizatat jo fitimprurëse - OJF-të, Shoqatat profesionale dhe Institucionet arsimore/trajnuese

Misioni

Misioni ynë është të ofrojmë vlerë të shtuar, duke u angazhuar në ndershmëri, dedikim ndaj rritjes së vijueshme të cilësisë së shërbimeve, transparencë dhe përgjegjshmëri.

Vizioni

Vizioni ynë ka të bëjë me përafrimin me standardet më të mira profesionale duke u bërë një shembull për transparencën dhe duke synuar integritetin profesional dhe përgjegjshmërinë.

Strategjia

Trajnimi i vijueshëm profesional dhe angazhimi në një kulturë pune gjithë përfshirëse. Në shërbim të kësaj strategjie realizohet analizë periodike e risqeve të brendshme dhe të jashtme, duke u ndërmarrë njëkohësisht plan-veprime për përmirësim të vazhdueshëm.

FINES është një kompani shqiptare me qendër në Tiranë. Klientela e saj shtrihet në të gjithë Shqipërinë. Nuk ka degë dhe asociime. Fines ka partner angazhimi në punën audituese Zj. Enkeleda Stefani e cila është regjistruar në regjistrin kombëtar të IEKA me nr. regjistri 208.

Pronësia, Struktura funksionale dhe sistematizimi i stafit

Njësia zotëron personalitetin juridik të personit fizik. Ajo është krijuar në tetor 2007, në Tiranë. Adresa aktuale është Njësia Administrative, Nr.5, Rruga Vaso Pasha, Ndërtesa nr.22, Hyrja Nr.23, Apartamenti Nr.4. Kodi postar nr.1019, Tiranë.

Njësia ka Kodin e saj të Etikës, Rregullore të rekrutimit dhe e menaxhimit të personelit, rregullore të procedurave të auditimit, Rregullore për Parandalimin e Pastrimit të Parasë dhe Financimit të Terrorizimit, të botuara në faqen e saj të internetit.

Në thelb ofrohen tre shërbime. Ata janë auditimi, kontabiliteti dhe konsulenca ekonomike. Në përputhje me këto funksione kompania ka një strukturë të sheshtë dhe tre degë, secila për funksionin përkatës. Në shoqërinë tonë vlerësohen trajtimi i vijueshëm dhe aftësi personal dhe njerëzor. Për këtë arsye zhvillohen trajtime periodike në fushën e auditimit, standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, si dhe në fushën e taksimit.

Sistemi i kontrollit të cilësisë

Sistemi bazohet në standardet ndërkombëtare të auditimit. Duke qenë një shoqëri e vogël kontrolli i cilësisë paraqet avantazhe në përfitimin e cilësive maksimale. Fin-es ka rregullore të brendshme dhe kod

të etikës, rregullore të rekrutimit dhe menaxhimit të personelit, rregullore për parandalimin e pastrimit të parasë.

Sistemi synon sigurimin e cilësisë më të mirë duke vështuar maksimizimin e vijueshëm të saj. Në përputhje me këtë realizohet kontrole periodike.

Sistemi i kontrollit dhe sigurimit të cilësisë përfshin politika dhe procedura që adresojnë përgjegjësitë e udhëheqjes për sistemin e kontrollit të cilësisë, kërkesat etike, pranimin e klientit, angazhimin dhe vazhdimësinë, burimet njerëzore, performancën e angazhimit dhe monitorimin.

Auditimi i njësive ekonomike me interes publik

Në vitin 2024 është realizuar auditimi i shoqërive me interes publik që është zhvilluar në bashkëpunim me shoqërinë e auditimit Kreston Albania. Kjo ka siguruar një cilësi në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator.

Informacioni financiar

	në mijë lekë	
	2024	2023
Auditim ligjor i njësive me interes publik	706	699
Auditim ligjor i njësive jo me interes publik	2,892	2,820
Të tjera	5,138	3,963
Totali	8,736	7,482

Në vitin 2024 nuk është angazhuar ortak angazhimi tjetër përveç Zj. Enkeleda Stefani

Deklarata e praktikave të pavarësisë të shoqërisë audituese

Stafi drejtues i FINES është i ndërgjegjshëm se cilësia në shërbimin e auditimit përbën një limit, i cili kërkon përpjekje të vazhdueshme. Në përputhje me këtë qasje është ngritur procedurë për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë e cila është bërë dhe pjesë e rregulloreve të brendshme. Gjithashtu janë zhvilluar kontrole periodike të vetëvlerësimit.

Duke marrë të gjithë këto evidenca së bashku, drejtuesit e FINES konfirmojnë me një shkallë sigurie të arsyeshme se sistemet e kontrollit të cilësisë janë realizuar efektivisht për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024.

Gjithashtu është realizuar një regjistrim i risqeve me të cilat përballen shoqëria dhe janë ndërtuar plan veprimet për përmirësim të gjendjes.